

VENDIM
Nr. 476, datë 9.6.2017

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR MONITORIMIN E FUSHATËS
ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MË 25 QERSHOR 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 86, pika 2, dhe 87, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 1, të nenit 24/4, të ligjit nr. 90/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh për të kryer monitorimin e fushatës zgjedhore të partive politike, në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, më 25 qershor 2017.

2. Fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama